



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Nr. 1374 Prot.

Korçë, më 08/08/2019

Nr. 301 Prot.

Tiranë, më 13.08.2019

MARRËVESHJE

për

BASHKËPUNIM NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

ndërmjet

UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

dhe

AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Universiteti "Fan S. Noli", i përfaqësuar nga Rektori prof. dr. Ali Jashari dhe Akademia e Studimeve Albanologjike, i përfaqësuar nga Rektori Akademik, prof. dr. Marenglen Verli, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimeve të shumanshme në funksion të zhvillimit institucional.

I

Bashkëpunimi ndërmjet të dy institucioneve do të përfshijë:

- a) fushat akademike me interes të përbashkët bazuar në parimet e barazisë dhe reciprocitetit;

- b) shkëmbimin e stafit akademik, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarive kërkimore shkencore;
- c) nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore;
- d) nxitjen, mbështetjen dhe realizimin veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
- e) shkëmbimin e literaturës shkencore;
- f) hulumtimi i arkivave dhe bibliotekave të ASA nga personeli akademik dhe studentët e Universitetit

II

Të dy institucionet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe të potencialit të disponueshëm nga secili institucion. Për detajimin e bashkëpunimit në fushat e mësipërme (I/a-f) dhe ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjes, ngrihet një Komision i Përbashkët i përbërë nga 3 përfaqësues nga secili institucion.

III

Çdo nen i kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të dy institucioneve.

IV

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse, kur të dy institucionet janë dakord për këtë. Mosrinovimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga pala e interesuar të paktën 3 muaj përpara përfundimit të saj.

Për Universitetin "Fan S. Noli"

Për Akademinë e Studimeve Albanologjike

REKTORI

Prof. dr. Ali Jashari



REKTORI

Akademik Prof. dr. Marenglen Verli

